



UDHËZUES I SHKURTËR

PËR PUNONJËSIT
E KUJDESIT
SHËNDETËSOR

IDENTIFIKIMI DHE
MBËSHTETJA E
VIKTIMAVE TË
TRAFIKIMIT TË
QENIEVE NJERËZORE

Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (Instrumenti Horizontal II) 2019-2022 është një nismë bashkëpunimi e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë. Programi mbështet proceset e reformave të rena dakord me autoritetet, sipas rekomandimeve përkatëse të organeve përkatëse këshillëdhënëse dhe monitoruese të Këshillit të Evropës, në fushën e të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe demokracisë.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon “© Këshilli i Evropës, 2022”. Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t’i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

Kopertinat dhe dizajni grafik: Nikolina Janeva
Fotoграфи: Canva

© **Këshilli i Evropës.**

I liçencuar në Bashkimin Evropian
në kushte të caktuara,
tetor 2022

Shtypi: Print Mark

Projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Parandalimi dhe luftimi i trafikimit të qenieve njerëzore ne Maqedoninë e Veriut” e mbështet zbatimin e rekomandimeve të Grupit të ekspertëve kundër trafikimit të qenieve njerëzore (GRETA).

Më shumë informacione rreth projektit dhe publikimeve janë në dispozicion tek:

Zyra e Programeve të Këshillit të Evropës në Shkup
Adresa: Qendra Soravia, rr. Filip Vtori Makedonski nr. 3.
1000, Shkup

Ueb faqe: <https://www.coe.int/en/web/skopje>

Për botimin kontribuan: Dr. Marija Risteska, Qendra për hulumtime dhe krijim të politikave; Prof. Dr. Elena Qosevska dhe M.Sc. Nadica Totic, Instituti i shëndetit publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut; Doc. Dr. Daniela Ivanova Panova, Klinika Universitare për gjinekologji dhe obstetrikë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”- Shkup; Marija Todorovska, Porta e Hapur dhe Dr. Jorg Pont, ish-këshilltar i shëndetësisë në Ministrinë e drejtësisë së Austrisë.

PËRMBAJTJA

- 01** – Ç'është trafikimi i qenieve njerëzore?
- 02** – Format e trafikimit të qenieve njerëzore
- 03** – Indikatorët e identifikimit
- 04** – Gratë si viktime të trafikimit të qenieve njerëzore
- 05** – Fëmijët dhe adoleshentët
- 06** – Gjendjet shëndetësore

01

Ç'ËSHTË TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE?

Trafikimi i qenieve njerëzore është rekrutim, transferim, transportim, strehim ose pranim i fëmijëve, grave ose burrave nëpërmjet përdorimit të forcës, detyrimit, abuzimit të pozicionit të vulnerabilitetit, mashtrimit ose mjeteve të tjera të palejueshme për qëllime eksploatimi.¹

SEKTORI I SHËNDETËSISË ËSHTË LOJTAR KYÇ NË IDENTIFIKIMIN DHE MBËSHTETJEN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe viktimat e formave të tjera të abuzimit, pësojnë lëndime dhe sëmundje që shpesh bien nën përgjegjësinë e sektorit shëndetësor për t'i trajtuar në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale.

Për një person të trafikuar, kontakti me dikë në sektorin e shëndetësisë mund të jetë mundësia e **parë - ose e vetme** - për të shpjeguar se çfarë ka ndodhur ose për të kërkuar ndihmë.

KONTAKTET DHE UDHËZIMET

PORTA E HAPUR

☎ 2777 - 070

www.lastrada.org.mk

SOS LINJA

☎ 0800 - 11111

QENDRA E VIKTIMAVE

☎ 070 359 971

POLICIA

njësia kundër trafikimit

☎ 192

EKIPE MOBILE

☎ 078 306 225

www.nacionalnakomisija.gov.mk

¹ Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC)

02

FORMAT E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

- Eksploatimi seksual;
- Eksploatimi në punë duke përfshirë bujqësinë, ndërtimtarinë, përpunimin e ushqimit, hotelierin, industrinë (në fabrika);
- Kërkim-lëmoshe e detyruar;
- Martesat e detyruara;
- Skllavërimi shtëpiak;
- Krimi i detyrueshëm, përfshirë krimin e rrugës dhe vjedhje të vogla;
- Heqja e organeve.

KUSHDO MUND TË JETË VIKTIMË
e trafikimit të qenieve njerëzore.



03

SHENJAT QË TREGOJNË QË PACIENTI ËSHTË VIKTIMË E MUNDSHME E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE


- **Shoqërohet** nga një person tjetër që duket kontrollues dhe insiston të japë informacion dhe të flasë në emër të tij/saj;
- Duket se ka **frikë** të flasë në prani të personit që e shoqëron;
- Jep shpjegim **të paqartë dhe jokonsistent** se ku jeton, punon ose mëson;
- Ka **lëndime** të vjetra ose të rënda të pa trajtuara dhe refuzon të shpjegojë se si ka ndodhur lëndimi;
- Duket se **transferohet/lëviz shpesh** (në nivel lokal, rajonal, kombëtar ose ndërkombëtar);
- Pamja tregon neglizhencë **të përgjithshme fizike**;
- **Nuk flet** në gjuhët që fliten në vend;
- **Nuk** posedon dokumente.

Më shumë informacion në lidhje me **Procedurat Standarde Operative (SOP)** dhe **Indikatorët** për identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore mund të gjeni në faqen e internetit të Komisionit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe Migrimit Ilegal: nacionalnakomisija.gov.mk²

² *Procedurat Standarde të Operimit - Komisioni Nacional (nacionalnakomisija.gov.mk).
Indikatorët - Komisioni Nacional (nacionalnakomisija.gov.mk).*

04

GRATË SI VIKTIMA TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE



Në Republikën e Maqedonisë së Veriut **viktima** të eksploatimeve seksuale **kryesisht** janë vajzat dhe gratë.

- Viktima **nuk** ka ku të jetojë nëse kthehet në komunitetin e saj;
- Viktima vazhdimisht **fajëson** veten për gjithçka që ndodh;
- Viktima është e **shqetësuar** dhe/ose e **frikësuar** kur flet për veten dhe për jetën në familje;
- Viktima **nuk beson** se institucionet mund ta ndihmojnë;
- Viktima **tërhiqet** në vetvete, ka frikë t'u përgjigjet pyetjeve dhe kërkon miratim ose pëlqim nga shoqëruesi i saj.

05

FËMIJËT DHE ADOLESHENTËT SI VIKTIMA TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

- Kanë një **relacion të paqartë** me personin që i shoqëron;
- Vërehet një ndjenjë **frike dhe shqetësimi** kur janë pranë personit që i shoqëron;
- **Zhduken** shpejt nga mbikëqyrja shëndetësore, nga shkolla, shtëpia etj.;
- Japin informacione **jokonsistente** për moshën e tyre.



06

GJENDJET SHËNDETËSORE

të cilat mund të implikojnë trafikimin e qenieve njerëzore

- Dëshmi të dëmtimeve të shumëfishta afatgjate;
- Indikacione të traumave mendore, fizike dhe seksuale;
- Infeksionet seksualisht të transmetueshme;
- Shtatzëne me kujdes antenatal të vonuar ose shtatzëni adoleshente;
- Të ushqyerit e dëmtuar dhe i dobët, kequshqyerja dhe dehidrimi;
- Dëshmi për vetëlëndime;
- Lëndime ose sëmundje nga ekspozimi ndaj kimikateve të dëmshme;
- Gjendja e keqe e dhëmbëve;
- Lodhje kronike;
- Dhimbje shpine, dhimbje stomaku, probleme me lëkurën;
- Dhimbje koke dhe marramendje;
- Simptoma jo specifike të stresit post-traumatik;
- Ankthi/sulmi i panikut (p.sh. gulçim, dhimbje gjoksi);
- Simptomat e çrregullimeve psikiatrike dhe psikologjike.

Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore mund të tërheqin vëmendjen tuaj vetëm kur janë **të sëmurë seriozisht** ose **të lënduar** ose kur kanë lëndim/sëmundje që nuk është trajtuar një kohë të gjatë.

Personat me aftësi të kufizuara janë një **kategori** veçanërisht **e cenueshme e qytetarëve** që mund të jenë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore.

MBANI MEND



- Personat e trafikuar nuk e njohin veten si viktima të trafikimit të qenieve njerëzore;
- Viktimat e kanë të vështirë të zbulojnë përvojën e tyre për shkak të frikës, turpfit, barrierave gjuhësore dhe mungesës së mundësive për ta bërë këtë;
- Mund të duhet kohë që viktima të ndihet mjaft e sigurt për të folur;
- Kujdesi në lidhje me moshën - nëse një person ju thotë se është nën 18 vjeç, ose nëse dikush thotë se është i rritur, por ju dyshoni se nuk është, atëherë veproni sikur të jetë nën 18 vjeç;
- Jini të kujdesshëm me burrat dhe djemtë që janë të eksploatuar seksualisht - përpiquni të mos i bëni ata të ndihen të gjykuar ose të paragjykuar;
- **GJITHMONË RASTI RAPORTOHET NËSE VIKTIMA ËSHTË FËMIJË NËN MOSHËN 18 VJEÇ.**

Të gjitha **masat** e marra **për mbrojtjen e viktimave** nga autoritetet duhet të jenë **urgjente** dhe të paraqesin prioritet dhe duhet t'u **përshtaten** nevojave të viktimave, **në përputhje** me moshën dhe **t'u përshtaten** personave me aftësi të kufizuara zhvillimore.

NËSE KENI DYSHIME

që dikush është viktimë, gjëja më e rëndësishme është që ti dhe viktima e mundshme të qëndroni të sigurt!

MOS U KONFRONTONI

sidomos në prani të personit që shoqëron viktimën e mundshme!

NDANI DYSHIMET TUAJA

me një anëtar tjetër të besueshëm të personelit!

KËRKO KËSHILLË

ose referoje pacientin në një organizatë të përshtatshme për kujdes social!

MOS BËNI DËM (DO NO HARM)

mos premtoni diçka që nuk mund ta plotësoni!

Nëse mendoni se siguria juaj është e kërcënuar,
raportoni në 192!

Mbështetja e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore është në dispozicion.

LINJA SOS FALAS

0800 11111

Paraqitja mund të jetë anonime.

Nxitni atë të lajmërohet për ndihmë ose për bisedë!

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

Këshilli i Evropës është organizatë prijëse e të drejtave të njeriut në Evropë. Përbëhet nga 46 vende anëtare, duke i përfshirë të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, marrëveshje e dedikuar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e monitoron implementimin e Konventës në vendet anëtare.

www.coe.int

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian vendosën t'i gërshetojnë njohuritë, mjetet dhe fatet e tyre. Bashkë, e ndërtuan hapësirën e stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, së këtejmi duke e ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë e individit. Bashkimi Evropian është i përkushtuar në ndarjen e arritjeve dhe vlerave të tij me vendet dhe njerëzit jashtë kufijve të tij.

www.europa.eu